


REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	2-D / DPK
Nr. I faq. Broj stranica Nr. pages	03
Nr. Prot. Br. Prot. Prot No	01-508/2013
Data Datum Date	20.02.2013
PRISHTINE	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE  
ANTI – CORRUPTION AGENCY**

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika d)si dhe 29.3 të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 09.01.2013, nxjerr këtë :

### **V E N D I M**

**I.** Mbyllët rasti me nr. AKK-03-3918/12, për z. Nezir Çoçaj, Drejtor i Institutit Pedagogjik të Kosovës, për shkak se nuk ka të dhëna të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.

**II.** Rasti mund të rihaqet në çdo kohë kur mund të paraqitet rrethana të reja.

### **A r s y e t i m**

Në rastin e shqyrtuar për konflikt të mundshëm të interesit është zhvilluar procedura e paraparë sipas nenit 18.1dhe 18.2 të ligjit Nr.04/L-051, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Pas informatës se marr nga një E-mail anonime në adresë të AKK-së, ka filluar shqyrtimi i lëndës me numër protokolli AKK-03-3918/12, që për trajtim ka pasur Zyrtarin e Lartë, z. Nezir Çoçaj, Drejtor i Institutit Pedagogjik të Kosovës.

Gjatë zhvillimit të procedurës dhe analizimit të gjendjes është konstatuar se zyrtari i lartë, gjatë kohës së ushtrimit të funksionit publik si, Drejtor i Institutit Pedagogjik të Kosovës, njëkohësisht është i angazhuar edhe në një tjeter detyrë, si Kryetar i Këshillit drejtues të Universitetit të Prishtinës.

Agjencia kundër Korrupsionit me datën 07.12.2012, e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në asatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet qe posedon Agjencia.

Pas këtyre procedurave, z. Nezir Çoçaj, pasi ka kontaktuar me zyrtarët e Agjencisë ka kërkuar të takohemi dhe të bisedojmë rrëth çështjes së ngritur, më datën 13.12.2012, është organizuar takimi me z. Çoçaj, ku dhe i kemi shpjeguar për fillimin e hetimeve lidhur me konfliktin e

mundshëm të interesit në ushtrimin e funksionit publik. Gjatë takimit zyrtari në fjalë e ka potencuar se ushtron funksionin e Drejtorit në Institutin Pedagogik të Kosovës, dhe njëkohësisht e ushtron edhe pozitën e Kryetarit të Këshillit drejtues të Universitetit të Prishtinës i emëruar sipas vendimit të Ministrit të Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë.

z. Nezir Çoçaj, ka theksuar se para se ta pranon detyrën e Kryetarit të Këshillit drejtues të Universitetit të Prishtinës, është konsultuar edhe me Ministrinë e Arsimit si dhe me jurist tjerë, sepse ka dashur të sigurohet dhe të mos lejoj që të gjendet në situatë që mund të shkaktoj gjendje të konfliktit të interesit. Pas përgjigjes se marr se nuk ka mos pajtueshmëri në mes të funksionit të Drejtorit të Institutit Pedagogik të Kosovës dhe Kryetarit të Këshillit drejtues të Universitetit të Prishtinës atë here ka pranuar ketë detyrë.

Gjatë prezantimit të provave dhe argumenteve tjera, zyrtari në fjalë është arsyetur se, pozita si drejtor Institutit Pedagogik të Kosovës, nuk mund të shkaktoj situatë të konfliktit të interesit me funksionin si Kryetarit i Këshillit drejtues të universitetit të Prishtinës, pasi që mendon se pozita e Kryetarit të Këshillit drejtues të universitetit të Prishtinës nuk hyn në pozitat e zyrtarëve të lartë, dhe nuk mendon që gjendet në konflikt të interesit, pasi që në funksionin si Kryetar të Këshillit drejtues të universitetit të Prishtinës nuk ka funksion ekzekutiv dhe nuk e ka punë të përhershme, por është i angazhuar vetëm gjatë takimeve që mban këshilli drejtues sipas rregullave të parapara, dhe nuk merr pagë të rregullt por paguhet sipas mbledhjeve të këshillit si lloj mëditje për takime, të cilat janë të parapara sipas rregullores në fuqi të UP-së, dhe nuk ka asnjë lidhshmëri në mes të këtyre dy funksioneve, që do të sjellin në situatë që munde të shkaktoj konflikt të interesit.


Duke u bazuar në dëshmitë e ofruara dhe gjendjen reale si dhe, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësive në punë e zyrtarit në fjalë, si dhe duke u bazuar në ligjin mbi Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr.04/L-037, neni 18.2, si dhe statutin e universitetit të Prishtinës dhe Ligjin Nr.04/L-051, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, neni 15 pika 2, ku thotë se (Zyrtari i lartë në cilësinë e anëtarit të organeve drejtuese dhe mbikëqyrës i personave juridik jo fitimprurës dhe personave juridik tjerë të cilat kryejnë punë nga lëmi i shkencës, sportit, arsimit, kulturës dhe veprimitarive humanitare, por nuk ka të drejtë të pranimit të kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimeve tjera të nevojshme, për veç nëse nuk parashihet ndryshe me ligje tjera), konsiderojmë se: ushtrimi i këtyre dy funksioneve si Drejtor i Institutit Pedagogik të Kosovës dhe si Kryetar i Këshillit drejtues të universitetit të Prishtinës nuk paraqesin mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik. Zyrtari i lartë z. Nezir Çoçaj në ketë periudhë nuk gjendet në situatë të konfliktit të interesit, mirëpo gjithmonë duke u zbatuar nenin 15 pika 3, e Ligjit Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Andaj u vendos si në diapositiv të këtij vendimi.

**II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.**

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./zni. (zyrtari përgjegjës)



Hasan Preteni  
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

*Preteni*